



**BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 48, datë 11.11.2015

Për

**“KRIJIMIN E TIRANA PARKING SI INSTITUCION NË VARËSI TË BASHKISË
TIRANË PËR ADMINISTRIMIN E SHËRBIMIT TË PARKIMIT PUBLIK ME
PAGESË”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 8, pika 1/VI, shkronja “b”, pika 1/I shkronja “ç”, nenit 16, pika 3, shkronja “a”, nenit 32, shkronjat “ç”, “d”, “dh” dhe nenit 33, pika 3 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); nenit 7, pika 8, shkronja “a”, nenit 37, pika 1, shkronjat “b” e “c” të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1619, datë 02.07.2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 527, datë 20.07.2011 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 28, datë 23.12.2014 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2015-2017 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2015” (i ndryshuar), me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë krijimin e Tirana Parking, si institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës. Detyrat kryesore institucionale e funksionale të këtij institucioni do të jenë si më poshtë vijon:
 - a. të administrojë shërbimin e parkimit publik me pagesë të Bashkisë së Tiranës, mbi tokë dhe nëntokë, në përputhje me zonat e përcaktuara për këtë qëllim;
 - b. të planifikojë dhe të ndjekë zbatimin e investimeve në infrastrukturën e nevojshme për shërbimin e parkimit publik me pagesë në Bashkinë e Tiranës;
 - c. të instalojë dhe mirëmbajë pajisjet dhe makineritë e parkimeve me pagesë;
 - ç. të instalojë dhe mirëmbajë sinjalistikën rrugore të parkimit;
 - d. të konstatojë dhe të vendosë gjoba për kundërvajtjet administrative lidhur me qëndrimi përtej orarit të caktuar dhe mospagesën e tarifës së parkimit;
 - e. të arkëtojë gjobat e vëna në kuadër të konstatimit të një kuandërvajtje administrative për shkelje që kanë të bëjnë me parkimin;
 - f. të kryejë çfarëdo lloj aktiviteti tjetër që nuk bie në kundërshtime e që lidhet direkt apo indirekt me përmbushjen e detyrave institucionale e funksionale, si dhe të kryejë detyrat që i ngakohen njësisë së qeverisjes vendore në kuadër të administrimit të pakimit tokësor dhe nëntokësor me pagesë;
 - g. t'i propozojë Bashkisë së Tiranës përmirësimin e politikave të administrimit të parkimit tokësor dhe nëntokësor me pagesë.

2. Të ardhurat e gjeneruara nga Tirana Parking në zbatim të pikës 1 ndahen 90% për Bashkinë e Tiranës dhe 10% për Tirana Parking. Të ardhurat xhirohen në llogarinë e të ardhurave të Bashkisë së Tiranës dhe Tirana Parking kryen çdo muaj akt-rakordimet me Degën e Thesarit dhe raporton në Bashkinë e Tiranës.
3. Të miratojë stemën zyrtare të Tirana Parking, sipas Aneksit nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Të miratojë numrin e përgjithshëm të punonjësve të Agjensisë "Parking Tirana" në 105 (njëqind e pesë) punonjës.
5. Të miratojë nivelin e pagave për punonjësit Tirana Parking, sipas Lidhjes së Pagave nr.16, Aneksi nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.
6. Efektet financiare të këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i Aparatit të Bashkisë për vitin 2015, duke reflektuar shtesat dhe pakësimet brenda Programit të Menaxhimit të Rrugëve dhe Programit të Transportit Publik dhe Programit të Zhvillimit Ekonomik dhe Punësimit, sipas Aneksit nr. 3 bashkëlidhur këtij vendimi.
7. Në mbështetje të pikës 1 të këtij vendimi të identifikohen dhe të ndiqen procedurat për kalimin kapital të aseteve, ambienteve, pajisjeve të domosdoshme për përmbushjen e detyrave funksionale/institucionale të Tirana Parking.
8. Në mbështetje të pikës 4 të këtij vendimi rekomandohet hartimi dhe miratimi i menjëhershëm i strukturës organizative dhe i rregullores së funksionimit të brendshëm të Tirana Parking.
9. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Menaxhimit të Shërbimeve, Drejtoria e Planifikimit Strategjik, Tirana Parking për zbatimin e këtij vendimi.
10. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

ALDRIN DALIPI





TIRANA
P A R K I N G

ANEKSI NR. 2**Lidhja Nr.16****Niveli i pagave për punonjësit e Tirana Parking**

Nr	Pozicioni	Paga individuale			Paga mujore	
		Kategori a	Grupi	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për pozicion	Shtesa për kushte pune
			1	2	3	
1	Drejtor i Përgjithshëm	II-a	1	2%	105 000	
2	Drejtor	II-b	1	2%	85 000	
3	Përgjegjës sektori, Kryeinspektor	III-a	1	2%	69 000	
4	Inspektor	III-b	1/2	2%	52 000	
5	Specialist I	III-b	1/2	2%	52 000	
6	Specialist II	IV-a	1/2/3	2%	41 000	
7	Punonjës shërbimi, shofer				34 000	
8	Pastrues, Roje				30 000	

Shtesa për vjetërsi në punë për **Lidhjen Nr. 16** të jepet në masën **2%** pas çdo viti pune, deri në **25 vjet**, dhe të llogaritet mbi **pagën e grupit**.

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT TË LARTË

Grupi i diplomës	Lloji i diplomës	Vlera
1	Diplomë e arsimit të lartë:	
1	Master i Shkencave Master i Arteve Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	14 000 lekë
2	Master profesional Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	11 000 lekë
3	Bachelor Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	10 000 lekë

Aneksi nr 3

NDRYSHIM BUXHETI PER VITIN 2015 PER KRIJIMIN E AGJENCISE TIRANA PARKING

SHTESA

Në Lekë

		Artikulli 600	Artikulli 601	Artikulli 602	Artikulli 231	Totali
I	PROGRAMI I MENAXHIMIT TERRUGEVE DHE TRANSPORTIT PUBLIK	8.100.000	1.300.000	2.578.000	11.222.000	23.200.000
A	Agjencia e Parkimit Gr.00 Tit. 04530 Kap. 5	8.100.000	1.300.000	2.578.000	0	11.978.000
a	Shpenzime personeli	8.100.000	1.300.000			9.400.000
b	Shpenzime Operative			2.578.000		2.578.000
B	Aparati Bashkisë Gr.00 Tit. 04530 Kap. 5	0	0	0	11.222.000	11.222.000
a	Shpenzime për investime				11.222.000	11.222.000
1	Pajisje +Bateri				7.900.000	
2	Kablla				177.000	
3	Printera				546.000	
4	Inventer				353.000	
5	Sistemi vëzhgimi				504.000	
6	Kabina				1.512.000	
7	Kasa k.tatimor				118.000	
8	Kasa lekeve				76.000	
9	Pajisje zyre (arka)				36.000	

PAKËSIMI

		Artikulli 600	Artikulli 601	Artikulli 602	Artikulli 231	Totali
I	PUBLIK	0	0	23.200.000		23.200.000
A	Aparati Bashkisë Gr.00 Tit. 04530 Kap. 5					
	Shpenzime operative	0	0	13.200.000		13.200.000
B	PROGRAMI I ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE PUNESIMIT					
	Aparati Bashkisë Gr.00 Tit. 04970 Kap. 5					
	Shpenzime operative	0	0	10.000.000		10.000.000



BASHKIA E TIRANËS

Nr. prot. 16574
2015

Tiranë 02/11/2015

Drejtuar: z. Aldrin Dalipi
Kryetar
Këshilli Bashkiak i Tiranës


Lënda : . Dërgohet material për shqyrtim e miratim

I nderuar z. Dalipi,

Bashkëlidhur po ju dërgojmë për shqyrtim e miratim relacionin dhe projekt-vendimin për “Krijimin e Tirana Parking si institucion në varësi të Bashkisë Tiranë për administrimit e shërbimit të parkimit publik me pagesë”.

Me respekt

K R Y E T A R I


Erion Veliaj



**BASHKIA E TIRANËS
KËSHILLI BASHKIAK**

Vendim (Projekt)

Nr. _____ datë _____ 2015

Për

**“Krijimin e Tirana Parking si institucion në varësi të Bashkisë Tiranë për administrimit
e shërbimit të parkimit publik me pagesë”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 8, pika 1/VI, shkronjat “b” dhe “ç”, nenit 16, pika 3, shkronja “a”, nenit 32, shkronjat “ç”, “d” e “dh” dhe nenit 33, pika 3 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); nenit 7, pika 8, shkronja “a”, nenit 37, pika 1, shkronjat “b” e “c” të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1619, datë 02.07.2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 527, datë 20.07.2011 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 28, datë 23.12.2014 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2015-2017 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2015” (i ndryshuar), me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë krijimin e Tirana Parking, si institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës. Detyrat kryesore institucionale e funksionale të këtij institucioni do të jenë si më poshtë vijon:
 - a. të administrojë shërbimin e parkimit publik me pagesë të Bashkisë së Tiranës, mbi tokë dhe nëntokë, në përputhje me zonat e përcaktuara për këtë qëllim;
 - b. të planifikojë dhe të ndjekë zbatimin e investimeve në infrastrukturën e nevojshme për shërbimin e parkimit publik me pagesë në Bashkinë e Tiranës;
 - c. të instalojë dhe mirëmbajë pajisjet dhe makineritë e parkimeve me pagesë;
 - ç. të instalojë dhe mirëmbajë sinjalistikën rrugore të parkimit;
 - d. të konstatojë dhe të vendosë gjoba për kundërvajtjet administrative lidhur me qëndrimi përtej orarit të caktuar dhe mospagesën e tarifës së parkimit;
 - e. të arkëtojë gjobat e vëna në kuadër të konstatimit të një kuandërvajtje administrative për shkelje që kanë të bëjnë me parkimin;
 - f. të kryejë çfarëdo lloj aktiviteti tjetër që nuk bie në kundërshtime e që lidhet direkt apo indirekt me përmbushjen e detyrave institucionale e funksionale, si dhe të kryejë detyrat që i ngakohen njësisë së qeverisjes vendore në kuadër të administrimit të pakimit tokësor dhe nëntokësor me pagesë;

- g. t'i propozojë Bashkisë së Tiranës përmirësimin e politikave të administrimit të parkimit tokësor dhe nëntokësor me pagesë.
2. Të ardhurat e gjeneruara nga Tirana Parking në zbatim të pikës 1 ndahen 90% për Bashkinë e Tiranës dhe 10% për Tirana Parking. Të ardhurat xhirohen në llogarinë e të ardhurave të Bashkisë së Tiranës dhe Tirana Parking kryen çdo muaj akt-rakordimet me Degën e Thesarit dhe raporton në Bashkinë e Tiranës.
 3. Të miratojë stemën zyrtare të Tirana Parking, sipas Aneksit nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
 4. Të miratojë numrin e përgjithshëm të punonjësve të Agjensisë "Parking Tirana" në 105 (njëqind e pesë) punonjës.
 5. Të miratojë nivelin e pagave për punonjësit Tirana Parking, sipas Lidhjes së Pagave nr.16, Aneksi nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.
 6. Efektet financiare të këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i Aparatit të Bashkisë për vitin 2015, duke reflektuar shtesat dhe pakësimet brenda Programit të Menaxhimit të Rrugëve dhe Programit të Transportit Publik dhe Programit të Zhvillimit Ekonomik dhe Punësimit, sipas Aneksit nr. 3 bashkëlidhur këtij vendimi.
 7. Në mbështetje të pikës 1 të këtij vendimi të identifikohen dhe të ndiqen procedurat për kalimin kapital të aseteve, ambienteve, pajisjeve të domosdoshme për përmbushjen e detyrave funksionale/institucionale të Tirana Parking.
 8. Në mbështetje të pikës 4 të këtij vendimi rekomandohet hartimi dhe miratimi i menjëhershëm i strukturës organizative dhe i rregullores së funksionimit të brendshëm të Tirana Parking.
 9. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Menaxhimit të Shërbimeve, Drejtoria e Planifikimit Strategjik, Tirana Parking për zbatimin e këtij vendimi.
 10. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

Aldrin Dalipi



TIRANA
P A R K I N G

ANEKSI NR. 2**Lidhja Nr.16****Niveli i pagave për punonjësit e Tirana Parking**

Nr	Pozicioni	Paga individuale			Paga mujore	
		Kategori a	Grupi	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për pozicion	Shtesa për kushte pune
			1	2	3	
1	Drejtor i Përgjithshëm	II-a	1	2%	105 000	
2	Drejtor	II-b	1	2%	85 000	
3	Përgjegjës sektori,Kryeinspektor	III-a	1	2%	69 000	
4	Inspektor	III-b	1/2	2%	52 000	
5	Specialist I	III-b	1/2	2%	52 000	
6	Specialist II	IV-a	1/2/3	2%	41 000	
7	Punonjës shërbimi, shofer				34 000	
8	Pastrues,Roje				30 000	

Shtesa për vjetërsi në punë për **Lidhjen Nr. 16** të jepet në masën **2%** pas çdo viti pune, deri në **25 vjet**, dhe të llogaritet mbi **pagën e grupit**.

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT TË LARTË

Grupi i diplomës	Lloji i diplomës	Vlera
1	Diplomë e arsimit të lartë:	
1	Master i Shkencave Master i Arteve Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	14 000 lekë
2	Master profesional Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	11 000 lekë
3	Bachelor Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	10 000 lekë

Aneksi nr 3
NDRYSHIM BUXHETI PER VITIN 2015 PER KRIJIMIN E AGJENCISE TIRANA PARKING

Në lekë

SHTESA

	Artikulli 600	Artikulli 601	Artikulli 602	Artikulli 231	Totali
I PROGRAMI I MENAXHIMIT TE RRUGEVE DHE TRANSPORTIT	8,100,000	1,300,000	2,578,000	11,222,000	23,200,000
A Agjencia e Parkimit Gr.00 Tit. 04530 Kap. 5	8,100,000	1,300,000	2,578,000	0	11,978,000
a Shpenzime personeli	8,100,000	1,300,000			9,400,000
b Shpenzime Operative			2,578,000		2,578,000
B Aparati Bashkisë Gr.00 Tit. 04530 Kap. 5	0	0	0	11,222,000	11,222,000
a Shpenzime për investime				11,222,000	11,222,000
1 Pajisje +Bateri				7,900,000	
2 Kablla				177,000	
3 Printera				546,000	
4 Inventer				353,000	
5 Sistemi vezhgimi				504,000	
6 Kabina				1,512,000	
7 Kasa k.tatimor				118,000	
8 Kasa lekeve				76,000	
9 Pajisje zyre (arka)				36,000	

PAKËSIMI

	Artikulli 600	Artikulli 601	Artikulli 602	Artikulli 231	Totali
I PUBLIK	0	0	23,200,000		23,200,000
A Aparati Bashkisë Gr.00 Tit. 04530 Kap. 5					
Shpenzime operative	0	0	13,200,000		13,200,000
B PROGRAMI I ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE PUNESIMIT					
Aparati Bashkisë Gr.00 Tit. 04970 Kap. 5					
Shpenzime operative	0	0	10,000,000		10,000,000



BASHKIA E TIRANËS

RELACION

Për

“Krijimin e Tirana Parking si institucion në varësi të Bashkisë Tiranë për administrimit e shërbimit të parkimit publik me pagesë”

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 8, pika 1/VI, shkronjat “b” dhe “ç”, nenit 16, pika 3, shkronja “a”, nenit 32, shkronjat “ç”, “d” e “dh” dhe nenit 33, pika 3 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); nenit 7, pika 8, shkronja “a”, nenit 37, pika 1, shkronjat “b” e “c” të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1619, datë 02.07.2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 527, datë 20.07.2011 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 28, datë 23.12.2014 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2015-2017 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2015” (i ndryshuar), me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe Menaxhimit të Shërbimeve, ju parashtrojmë se:

Hyrje

Ndarja e re territoriale e përball stafin e ri të Bashkisë me nevojën e një ndryshimi të plotë ristrukturues në mënyrën e administrimit dhe menaxhimit të gjithë shërbimeve të transportit.

Në kontekstin e ri urban me (i) një diversitet të lartë, (ii) rritje të numrit të popullsisë, (iii) rritje të numrit të automjeteve për banorë, (iv) kërkesa jo homogjene për lëvizje sipas zonave të ndryshme të qytetit, (v) nevojat për infrastrukturë funksionale që kanë grupe të popullsisë me densitet jo të madh por të shtrirë në territor, kërkohet një përqasje e mirëmenduar e në ofrimin e alternativave të lëvizshmërisë, parashikimin e ndërhyrjeve në kategoritë e transportit dhe mënyrës se si duhet menaxhuar trafiku.

Kësisoj, ndryshimet ekonomike, demografike, urbane, si dhe transformi social-kulturor në këto dy dekada kanë influencuar konsiderueshëm stilin e jetës në Tiranë dhe, në këtë aspekt, me mënyrën sesi udhëtojmë (mobilitetin)¹. Treguesi kryesor i ndryshimeve të ndodhura në mobilitetin urban është rritja e nivelit të motorizimit. Verifikohet një rritje në numrin e automjeteve të rregjistruara², ku Tirana aktualisht mbart rreth 40% të totalit të gjithë mjeteve të rregjistruara në Shqipëri. Pavarësisht se niveli aktual i motorizimit në Tiranë është 178

¹ Popullsia në Tiranë sipas Censurit 2012 është 720,000 banorë, duke e bërë kështu Tiranën qytetin më të madh në vend.

² Në vitin 2010 numri i automjeteve të regjistruara rezulton 734.701, ndërsa në vitin 2015 rezulton 888.074.

automjete për 1,000 banorë – pra, sa gjysma e mesatares Europiane - parashikohet të shënohet rritje në vitet e ardhshme.

Problematikat e shfaqura me rritjen e numrit të makinave dhe përdorimin e vazhdueshëm të tyre në Tiranë, janë të ndryshme:

- a. **moszbatimi i rregullave të parkimit në rrugë.** Koha e autorizuar e parkimit, tarifat e parkimit janë të përcaktuara nga Bashkia e Tiranës, por parkimi nuk menaxhohet në mënyrë efektive dhe të frytshme.
- b. **parkimi i paligjshëm në rrugë.** Parkimi jashtë zonës së përcaktuar zvogëlon numrin e korsive në përdorim dhe kjo shkakton çrregullim të trafikut, për pasojë, sjell uljen e kapacitetit të rrugëve, rritjen e kohës së udhëtimit etj.
- c. **administrimi i parkimit në orët e pikut.** Kërkesa për këtë shërbim shpesh përqendrohet duke shkaktuar mbingopje për një periudhë të caktuar të ditës. Kjo, në përgjithësi vërehet nga ora 9:00 deri në 14:00 në ndërtesat e zyrave, nga ora 11:00 deri në 14:00 në ndërtesat tregtare dhe nga ora 8:00 deri në 16:00 në parkimin në rrugë.
- d. **mungesa e kontrollit.** Në shumë raste punonjësit dhe Policia Bashkiake nuk e kanë plotësisht të mundur të kontrollojnë dhe të mbikëqyrin situatën në zonat e paracaktuara si vendparkim me pagesë kryesisht si shkak i stafit dhe mjeteve të pamjaftueshme për të kryer këtë funksion.
- e. **vështirësi në kryerjen e pagesës për vendparkime.** Duke marrë shembull bulevardin “Dëshmorët e Kombit” theksojmë se për të paguar biletën e parkimit, drejtuesi i automjetit duhet të përshkruajë një distancë të konsiderueshme për të paguar dhe pastaj për të vendosur pranë automjetit të tij biletën.
- f. **shfrytëzimin informal të vendeve të parkimit.** Në disa nga rrugët kryesore ndeshen individë privatë që rrethojnë me objekte të ndryshme hapësirat e destinuara për parkim, dhe kundrejt një vendi të lirë kërkojnë pagesa nga 100 – 150 lekë.
- g. **ndotjen mjedisore nga trafiku.** Për shkak të automjeteve që në pamundësi për të gjetur vendparkimi bëjnë lëvizje shtesë deri në gjetjen e një vendparkimi.

Aktualisht në Tiranë mund të ofrohen 2 lloje parkimi:

- **Parkimi mbi tokë.** I pozicionuar në rrugët e qytetit dhe në sheshet publike. Oferta e parkimit mbi tokë është e lidhur me politikat e Bashkisë së Tiranës për lëvizjen në qytet.
- **Parkimi nëntokë.** I organizuar në formën e parkimeve nën godinat e ndërtuara për funksione rezidenciale dhe mikse. Si dhe parkimin nëntokësor sipas Planit të Përgjithshëm Vendor për t’u zhvilluar ose jo në formë konçesionare nga Bashkia e Tiranës.

Ndërsa, në një prizëm organizativ administrimi i shërbimit të parkimit publik në Bashkinë e Tiranës aktualisht përfshin tre nivele:

1. **Drejtoria e Transportit dhe Lëvizshmërisë** harton e politikave të parkimit;
2. **Drejtoria e Përgjithshme e Tatim Taksave Vendore** administron parkimin e rezervuar me pagesë dhe parkimin publik me pagesë në përputhje me VKB nr. 3, datë 05.02.2007 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës” (i ndryshuar);
3. **Policia Bashkiake dhe Policia Rrugore** ushtrojnë kontrollin e zbatimit të rregullave të parkimit sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar).

Duke qënë se administrimi i sistemit të parkimit është i organizuar në këtë mënyrë, në përprjekje për të bashkërenduar punën, Drejtorive të Bashkisë ju duhet të bëjnë biseda dhe marrëveshje për të sqaruar dhe përcaktuar shkallën e mbështetjes nga secili sektor. Kjo situatë shpesh shkakton probleme në organizimin e përditshëm të punës dhe zgjidhjen e

problematikave gjatë ushtrimit të detyrës nga sektorët përkatës. Për më tepër, ky organizim nuk është praktik për të përballuar nevojat e shërbimit lidhur me parkimin.

Krijimi i Tirana Parking

Duke qenë se, nga njëra anë, pritshmëria e zhvillimit ekonomik dhe zhvillimi urban i qytetit, kontradiksioni midis dëshirës së qytetarëve për të pasur një mjet privat dhe politikave për të mundësuar alternativa lëvizje që janë më ekologjike, kërkon një plan transporti të mirëmenduar, ku njërin nga elementët kyç është **parkimi në rrugë dhe jashtë saj**.

Duke qenë se, nga ana tjetër, Bashkia e Tiranës ka mundësinë që të shikojë qytetin dhe disponibilitetin e tokës (në termat e metrave të seksionit të rrugës) - të përfutur nga përdorimi aktual dhe i ardhshëm i transportit urban - sipas një metode të integruar për çdo kategori transporti. Pas kësaj, duke ditur që është vizatuar rruga për përdoruesit, fokusi shkon tek zonat e parkimit që duhen përgjatë rrugës dhe jashtë saj.

Duke qenë se, Bashkia e Tiranës po i kushton një vëmendje të veçantë transportit dhe lëvizjes në qytetin e Tiranës, si një nga prioritetet më të rëndësishme të punës tonë në përmbushje të kërkesave dhe nevojave të qytetarëve dhe qytetit.

Duke qenë se, parkimi, si në rrugë, jashtë-rruge apo nëntokë është një aspekt i rëndësishëm dhe shumë kritik për një qytet, veçanërisht për një qytet qendër të aktiviteteve sociale dhe ekonomike si Tirana.

Duke qenë se, parkimi në një qytet u lejon klientëve të vizitojnë biznese dhe pjesë të tjera të qytetit, rezidentëve të qytetit të marrin mjete në pronësi dhe të planifikojnë shpërndarjen e tyre në aktivitetet sociale dhe ekonomike. Gjithashtu, parkimi është i nevojshëm në një qytet për të inkurajuar trafikun dhe kënaqur rezidentët e tij me aktivitete tregëtare, sociale etj.

Duke qenë se, sipas strukturës ekzistuese, pjesa e administratës që merret me përmbushjen e funksioneve kryesore të parkimit është brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, kurse funksionet administrativo/ ligjore dhe shërbimet e tjera mbështetëse sigurohen nga instanca të tjera të kësaj Drejtorie ose të Drejtorive të tjera të Bashkisë. Kjo do të thotë që stafi që administron parkimin nuk ka një kontroll direkt mbi një pjesë të madhe të burime që nevojiten për të drejtuar shërbimin e parkimit. Kështu, atyre i duhet të presin ose të kërkojnë që të jenë pjesë e planifikimit lidhur me nevojat që kanë për një administrim efikas duke konkuruar me nevojat e departamente të tjera të Bashkisë që kanë prioritete të tjera.

Referuar studimit “Një sistem parkimi për Tiranën” hartuar në vitin 2005 nga konsulentë Britanikë, citohet se përvoja në Mbretërinë e Bashkuar dhe në vende të tjera tregon se një sistem i administruar si një nën-sektor ose Drejtori brenda një Drejtorie të Përgjithshme me shumë prioritete nuk rezulton i suksesshëm. Burime të shërbimeve mbështetëse të domosdoshme për të ndihmuar në shërbimin e parkimit i caktohen çështjeve të një prioriteti më të lartë (sektori tjetër) duke lënë parkimin të pambështetur. Për të drejtuar operacionin e parkimit menaxherëve duhet t’u jepen fuqi dhe kopetenca për të marrë vendime dhe iniciativa kur nevojitet pa pasur nevojë që vendimi të kalojë nëpërmjet një procesi të gjatë burokratik.

Duke qenë se, administrimi strategjik dhe efikas i shërbimit të parkimit publik në Bashkinë e Tiranës parashikon të gjenerojë një rritje jo indiferente të të ardhurave të Bashkisë së Tiranës. Për shembull, nëse krahasojmë të ardhurat e mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore për muajin Tetor 2014 me të ardhurat e gjeneruara në Tetor

2015 vihet re se të ardhurat në total nga parkimi me ore për muajin tetor 2014 kanë qenë 772.000 Lekë (mbuluara nga 9 inspektorë). Ndërsa, në muajin tetor 2015 vetëm Eco Parking në Sheshi Italia ka mbledhur 1.500.000 Lekë dhe nëse përshihet këtu edhe parkimin me orë në pikat ekzistuese totali i të ardhurave për muajin tetor 2015 është 2.247.430 lekë (me 6 inspektore parkimi). Pra, midis dy periudhave shënohet një rritje prej 291 % në të ardhura nga vendosja në regjim eficient i parkimit në Sheshin Italia.

Si rrjedhim, nga sa u parashtua më lart dhe patur parasysh problematikat e përditshme që lidhen me parkimin shfaqet domosdoshmëria e krijimit i një institucioni varësie si Tirana Parking, si një institucion i specializuar dhe i fokusuar në çështjet e parkimit.

Tirana Parking synon të ketë një rol ekzekutiv në lidhje me zbatimin politikave të parkimit të hartuara nga Bashkia e Tiranës. Detyrat kryesore të këtij institucioni konsistojnë në:

- i) të administrojë shërbimin e parkimit publik me pagesë në Bashkisë e Tiranës, mbi tokë dhe nëntokë, në përputhje me zonat e përcaktuara për këtë qëllim dhe të vjelë të ardhurat e gjeneruara prej tij;
- ii) të planifikojë dhe të ndjekë zbatimin e investimeve në infrastrukturën e nevojshme për funksionimin e shërbimit e parkimit publik me pagesë në Bashkinë e Tiranës;
- iii) të instalojë dhe mirëmbajë pajisjet dhe makineritë e parkimeve me pagesë;
- iv) të instalojë dhe mirëmbajë sinjalistikën rrugore të parkimit.

Më tej theksojmë se Tirana Parking do të konstatojë dhe të vendosë gjoba për kundërvajtjet administrative lidhur me qëndrimi përtej orarit të caktuar dhe mospagesën e tarifës së parkimit. Ndërsa, Policia Bashkiake, mbështetur në nenin 12 të Ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar), do të konstatojë dhe vendos gjobat për kundërvajtjet administrative lidhur me parkimin e gabuar.

Iniciativa e propozuar për përcaktimin dhe administrimin e zonave të parkimit është një nismë serioze që do të angazhojë njerëz. Tirana Parking duhet të mundësojë identifikimin e personave me aftësi të nevojshme dhe të një strukturë funksionale për të arritur suksesin e këtij projekti, që ndër objektivat primar do të ketë ngritjen e një sistemi administrimi të parkimit në rrugët dhe sheshet kryesore të qytetit që janë në zonat me intesitet të lartë të kërkesës për parkim. Kjo, për të mbështetur politikën e transportit të Bashkisë Tiranë që dekurajojnë lëvizjen me mjete private dhe mundësojnë një mjedis më të pastër dhe më të jetueshëm.

Referuar studimit "Një sistem parkimi për Tiranën" hartuar në vitin 2005 nga konsulentë Britanikë, si dhe praktikave më të mira ndërkombëtare, alternativat e sistemeve teknologjike për tu aplikuar janë telefonia celulare, sistemi m-parking (MPS) si dhe sistemet e kohëmatjes së qëndrimit nëpërmjet aparaturave të posaçme apo si njihen parkimetra (PMS). Meqë Bashkia e Tiranës po implemeton me vonesë në raport me qytetet e tjera në Europë një sistem teknologjik në këtë fushë, ka avantazhin dhe mundësinë që gjithçka që ofrojnë sistemet e mësipërme të integrohen tërësisht në një paketë të vetme gjatë implementimit.

Bashkia do të implementojë një sistem manaxhues parkimi të kompjuterizuar dhe me softëare të avancuar për të menaxhuar aktivitetet e ndryshme që kërkon administrimi i parkimit. Sistemi do të jetë një sistem i hapur që nuk është i lidhur me një rrjet të veçantë të telefonisë celulare. Sisteme qendrore menaxhimi, sisteme komunikimi në kohë reale, sisteme të ndërtuara në mënyrë të integruar dhe komunikuese me njëri tjetrin, sisteme kontrolli nëpërmjet pajisjeve teknologjike që mundësojnë informacion e menjëhershëm nëse mjete ka

paguar tarifën e parkimit apo nëse ka detyrime të prapambetura, forma raportimi, certifikimi dhe administrimi financiar që mundësohen nga sistemi qëndror.

Bashkia e Tiranës është Bashkia më e madhe në Shqipëri, por qytete dhe bashki të tjera gjithashtu po fillojnë të kenë probleme me parkimin. Nëse Bashkia e Tiranës krijon një sistem m-parking dhe sistemet me parkimetra PMS shumë nga lehtësitë që do të krijohen do të ishin në gjendje të kishin një zbatim më të gjerë kombëtar dhe të lejonin bashkitë e tjera ta përvetësojnë të njëjtin sistem. Si pasojë, kur të përcaktohet cilin sistem të blejë dhe koston e blerjes dhe operimit, Bashkia duhet të jetë e ndërgjegjshme që mund të krijojë një sistem që mund të shitet ose të ndahet me bashki të tjera. Kjo do të ofronte Bashkisë një burim të vlefshëm të ardhurash shtesë në të ardhmen.

Struktura organizative e Tirana Parking

Struktura organizative e Tirana Parking me një numër fillestar prej 105 punonjësish do të jetë do të artikullohet në 3 bërthama operative kyç: (i) menaxhimi i kontratave, (ii) inspektorët e parkimit dhe (iii) departamenti i menaxhimit të sistemeve IT.

Bërthama e menaxhimit të kontratave do të administrojë shërbimin e parkimit të rezervuar si regjistrimin dhe manaxhimin e subjekteve sipas kërkesave, regjistrim dhe administrimin kontratës, mbylljen ose rinovimin e kontratave, administrimin e të dhënave financiare (faturat, pagesat), administrimin e detyrimeve, të hartojë raporte dhe të mbajë statistika mbi kontratat.

Inspektorët e Parkimit do të inspektojnë përdorimi e hapësirave të destinuara për parkim, respektimin e kufizimeve orare dhe vjeljen e të ardhurave prej tyre. Do të angazhohen gjithashtu në një informim konstant të publikut në lidhje me sistemin e parkimit të administruar nga Bashkia e Tiranës.

Bërthama e menaxhimit të sistemeve të teknologjisë dhe informacionit do të bëjë të mundur funksionimin e sistemeve të informacionit dhe mirëmbajtjen e rrjetit kompjuterik të institucionit, do të administrojë sistemin e akses kontrollit (Controll Room) të gjithë pajisjeve të instaluar për funksion parkimi dhe mban të gjitha komunikimet me kompanitë prodhuese të sistemeve për çdo nevojë të mundshme, kryen back up të programeve apo sisteme të parkimit që kontrollojnë dhe kërkon suport nga implementuesit e programeve baze, mirëmban dhe manaxhon programin e drejtorisë së burimeve njerëzore, bën të mundur funksionimin e sistemeve të informacionit dhe mirëmbajtjen e rrjetit kompjuterik server, pc, kartat e aksesit etj, kryen detyrat e përcaktuara në funksion të përmirësimit të kapaciteteve dhe strategjisë së Tirana Parking në fushën e inovacionit, teknologjisë duke ngritur një infrastrukturë profesionale.

Efektet financiare

Efektet financiare të këtij vendimi do të përballohen nga buxheti Buxheti i Aparatit të Bashkisë për vitin 2015, duke pakësuar shpenzimet operative për zëra të parealizuar të shpenzimeve të planifikuara në Programin e Menaxhimit të Rrugëve dhe Transportit Publik dhe Programin e Zhvillimit Ekonomik dhe Punësimit, si më poshtë:

Pakësohet buxheti i Aparatit të Bashkisë për zërat e mëposhtëm:

Programi i Menaxhimit të Rrugëve dhe Transportit Publik
Shpenzime operative (Gr.00 Tit. 04530 Kap. 5.Art. 602)

13.200.000 lekë

Programi i Zhvillimit Ekonomik dhe Punësimit
Shpenzime operative (Gr.00 Tit. 04970 Kap. 5.Art. 602) 10.000.000 lekë

Shtohet buxheti i Tirana Parking, si më poshtë:

Paga (Gr.00 Tit. 04530 Kap. 5. Art. 600) 8.100.000 lekë
Sig. Shoqerore (Gr.00 Tit. 04530 Kap. 5.Art.601) 1.300.000 lekë
Shpenzime Operative (Gr.00 Tit. 04530 Kap. 5. Art.602) 2.578.000 lekë

Shtohet buxheti i Aparatit të Bashkisë, si më poshtë:
Shpenzime Kapitale (Gr.00 Tit. 04530 Kap. 5.Art. 231) 11.222.000 lekë

Stela Fishta
Specialist i Sektorit të Asistencës Ligjore dhe Legjislacionit

Gentian Nechvatal
Përgjegjës i Sektorit të Rrjetit Rrugor

Kliton Jani
Përgjegjës i Sektorit të Sigurisë Rrugore

Jonida Halili
Drejtor i Planifikimit Strategjik

Taulant Tusha
Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe Menaxhimit të Shërbimeve,

Itena Ndroqi
Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse

Behar Zeneli
Sekretar i Këshillit Bashkiak

Arsela Gjonaj
Jurist i Këshillit Bashkiak